



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:046162
Datë: 09.02.2024
Numri i dokumentit: 05307802

CAP.nr.1435/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, nga gjyqtarja individuale Naime Ahmeti, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit P... B..... me adresë në S..... e C....., Viti, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.M., avokat në Lipjan, kundër debitorit A..... G....., 2004 sh.p.k, me seli në Gjilan, Rr. “A..... T.....”, nr.XX, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.L.G., me bazë juridike pagesë borxhi, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.87/23 të datës 04.08.2023, jashtë seance më datë 09.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të debitorit A..... G....., 2004 sh.p.k, me seli në Gjilan, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.87/23 i datës 04.08.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.87/23 të datës 04.08.2023, në pikën një të dispozitivit shpallet jokompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në çështjen juridike të kreditorit P... B....., me adresë në S..... e C....., Viti, Republika e Kosovës, me nr. fiskal601740401 dhe me nr. biznesi 71356922, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.M., avokat nga Lipjani, kundër debitorit A.... G..... 2004 sh.p.k, me adresë Rr. “A..... T.....”, nr.XX, Gjilan, Republika e Kosovës, me numër unik identifikues XXXXXX, lidhur me prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.XX/22 të datës 21.12.2022, të caktuar nga përmbartuesi privat B.T., në Ferizaj, në lëndën e udhëhequr me shenjën

PPP.nr.87/23. Në pikën dy, ka caktuar që pasi ky aktvendim të merr formë të prerë, lënda t'i dërgohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i debitorit, për shkak të shpalljes jokompetente në pikëpamje lëndore, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën në tërësi për ndryshimin dhe anulimin e aktvendimit PPP.nr.87/23 të datës 04.08.2023, lidhur me vendosjen e çështjes sipas prapësimit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori kundër debitorit ka paraqitur propozim për përmbarrim në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave, lidhur me borxhin në vlerë prej 2,397.85 euro. Përmbarruesi privat a lejuar përmbarrimin e kërkuar me urdhrin P.nr.XX/22 të datës 21.12.2022, ndaj të cili urdhër debitorit ka ushtruar prapësim ndërsa kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësim. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimit dhe përgjigjes në prapësim vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykatës së shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i çartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, drejtë është vërtetuar gjendja faktike dhe është zbatuar e drejta materiale, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e këtij aktvendimi, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejt ka vepruar kur ka është shpallur si jokompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur lidhur me prapësimin e debitorit pasi që duke u bazuar në dispozitën e nenit 13.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*. Në këtë rast kemi të bëjmë me pagesë borxhi, ku palët janë subjekte juridike dhe se kontesti rrjedh nga çështjet e tyre tregtare, nga çka rezulton se gjykata e shkallës së parë nuk ka kompetencë lëndore për të vendosur për këtë çështje dhe të drejtë është shpallur si gjykatë inkompetente.

Nuk qëndron pretendimi ankimor i të autorizuarit të debitorit se në bazë të nenit 17.3 të LPK-së, gjatë procedimit të çështjes ndryshohen rrethanat, gjykata që ka qenë kompetente me rastin e paraqitjes së padisë mbetet edhe me tutje kompetente, pasi që në rastin konkret lënda gabimisht është regjistruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dhe se e njëjta nga ana e përmbarruesit

privat është drejtuar për në Gjykatën Komerciale, meqë e njëjta është gjykatë kompetente lëndore për vendosje në bazë të Ligjit për Gjykatën Komerciale që nga fillimi i procedurës. Nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e të autorizuarit të debitorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1435/2023, me datë 09.02.2024

Gjyqtarja
Naime Ahmeti